

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarene vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, me zyrtarin ligjor Leutrim Hoti, në çështjen penale, kundër të pandehurit **G.K.**, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2750/17, të dt.26.09.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, PP.II.nr.2750/17, të dt.26.09.2017, më dt.**21.11.2017**, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2750/17, të dt.26.09.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMORË

I pandehuri: G.K. nga i ati Z., i lindur me ..., me vendbanim në fshatin G. KK. P., me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

S e p s e:

Me dt. 26.04.2017, rreth orës 18:30, në rrugën Fushë Kosovë-Sllatinë, e pikërisht në fshatin M. e E., i pandehuri derisa ishte duke drejtuar automjetin e markës “V Ë 1J” me targa të regjistrimit ..., ka qenë i përfshirë në aksident të trafikut i cili nga pakujdesia duke rënë nëkundërshtim me nenin 120/1 të ligjit për sigurinë në trafikun rrugor, ka vënë në rrezik veten dhe pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, nuk e përshtat shpejtësinë e lëvizjen kushteve dhe rrethanave të krijuara duke mos e mbajtur distancën e mjaftueshme në mes të automjeteve në atë mënyrë që me pjesën e përparme ballore të majtë, e godet në pjesën e pasme të djathtë automjetin e markës “VWPolo”, me targa të regjistrimit ..., të cilin e drejtonte B.M., e që nga incisioni i goditjes i njëjti humb kontrollin mbi automjet dhe me pjesën e përparme i godet mbrojtësit metalik të ndarjes fizike të rrugës, me ç’rast shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale dhe lëndime trupore, e ku lëndime trupore kanë marr: B.M., S.H.1, A.O. dhe S.H.2

- me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **300 (treqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet)€ të gjobës.

Obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të jenë sipas llogaris së kësaj gjykate, dhe në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit B.M., me banim në fshatin M. e P. nr. ... në F.K., S.H.1, A.O. nga L., dhe S.H.2 nga fshati M., K.K. L., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.2750/17, të dt.26.09.2017, e ka akuzuar G.K., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par. 6 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Raporti i Aksidentit 2017-TR-0136, i datës 26.04.2017, akt ekspertimi mjeko-ligjor në bazë të dokumenteve të çështjes i datës 23.07.2017, ekspertiza e komunikacionit e datës 27.08.2017, dhe foto dokumentacioni me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Pas vlerësimit me shumë kujdes të gjitha provave materiale të lartcekura, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë nga: ekspertiza e ekspertit të komunikacionit R.B. e dt. 27.08.2017, është konstatuar se deri te aksidentit i trafikut ka ardhur për shkak të lëshimeve nga ngasësi i automjetit G.K..

Në bazë të mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr.M.G., të datës 23.07.2017 për të dëmtuarit, lidhur me natyrën dhe shkallen e lëndimeve trupore konstatohet se lëndimet e tyre bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore.

Duke u bazuar në këto që u cekën me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri G.K., është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, është marr në bazë të nenit 450 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.4393/17, i dt.21.11.2017

Zyrtari Ligjor
Leutrim Hoti

Gjyqtarja,

Lumnije Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.